



RAPORT

**ROLI I PSIKOLOGUT DHE PUNONJËSIT SOCIAL NË KUADRIN E
AKSESIT QYTETAR NË ORGANET E DREJTËSISË, SI DHE PËR
MBROJTJEN E INTERESIT MË TË LARTË TË TË MITURVE.
(*RASTI I SHQIPËRISË*)**

ME MBËSHTETJEN E CIVIL RIGHTS DEFENDERS

Tiranë, 2014

Ky raport u hartua Nga Qendra Për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) dhe Shërbimi Ligjor Falas, (TLAS), në kuadër të zbatimit të projektit “Forcimi i grave në nevojë dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi adresimin e diskriminimit gjinor dhe dhunës në familje përmes dramatizimeve dhe shfaqjeve”.

Përmbajtja e Lëndës

Hyrje.

- 1. Legjislacioni shqiptar për pjesëmarrjen e psikologut në sistemin gjyqësor (Procesi civil e penal).**
- 2. Roli i ekspertit psikolog në procesin gjyqësor për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.**
- 3. Organizimi i shërbimit të ekspertizës së psikologut/punonjësit social. Përvoja e Shqipërisë.**
- 4. Përvoja e qendrave që ofrojnë shërbim ligjor falas, (QNL, TLAS), në identifikimin e problematikave në ekspertizën e psikologut/punonjësit social ndaj fëmijëve dhe palëve ndërgjyqëse.**
- 5. Një listë e problemeve reale që paraqiten gjatë procedimit ligjor në gjykatat shqiptare.**
- 6. Përmbledhje e konkluzioneve dhe sugjerimeve**

Hyrje.

Kodi i Familjes,¹ solli një aktor të ri të procesit civil familjar, konkretisht psikologun ose punonjës social. Prania e ekspertit psikolog/punonjës social është i nevojshëm për shkak të përfshirjes së personave të mitur në procedurat ligjore të së drejtës familjare, si zgjidhje martesë, kujdestari, heqje e përgjegjësisë prindërore, si edhe në rastet e të miturve në konflikt me ligjin për procedurat pranë Gjykatave, Zyrave të Prokurorisë ose Komisariateve të Policisë.

Rastet që kërkonin përfshirjen e të miturit në të gjitha nivelet e hetimit dhe procedimit gjyqësor, që nga marrja e tij në pyetje, në Komisariatin e Policisë, Prokurori dhe Gjykatë, sollën në vëmendjen e ekspertëve të ligjit nevojën për të mbrojtur e sanksionuar të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar gjatë hetimit dhe gjykimit gjyqësor, në prani të një profesionisti (psikolog/punonjës social/sociolog) ose të përfaqësuesit ligjor (prind/kujdestar ligjor).

Ndryshimet e Kodit të Familjes gjithashtu, vendosën në qendër të çështjes ligjore kryerjen e vlerësimit psikologjik nga një psikolog dhe vlerësimit të situatës sociale familjare nga punonjës social apo sociolog. Kjo nxori në pah nevojën që në rastin e çështjeve gjyqësore të zgjidhjes së martesës të përdorëshin dijet dhe kompetencat e psikologut, dhe/ose të punonjës social, pa bërë një përcaktim specifik se kur mund të japë vlerësimin e tij njëri, apo tjetri. Për Kodin e Familjes referimi ndaj ekspertit psikolog/punonjës social/sociolog, është i njëjtë në rastin e zgjidhjes së martesës, duke e bërë rolin e tyre ekuivalent të njëri-tjetrit në të tilla çështje. Për mendimin tim, një zgjedhje e tillë e bërë nga legjislatori, duke i lënë një rol të barabartë pjesëmarrjes së të dy ekspertëve në rastin e Zgjidhjes së martesës, mund vijë si rezultat i rasteve të çifteve më fëmijë të mitur, të cilët për nga zhvillimi i tyre psikologjik e fizik nuk mund të merren në pyetje drejtpërdrejt, gjë që bën më të pranueshme një vlerësim social të gjendjes sociale të familjes nga punonjësi social apo sociologu, apo ndoshta duke i zgjeruar mundësitë gjykatës (në rastet e zgjidhjes së martesës së çifteve me fëmijë të mitur) që në krijimin e bindjes së saj të kërkojë vlerësimin nga të dy ekspertët. Vlen të nënvizohet që, përveç çështjeve familjare të lartpërmendura (zgjidhje martesë), psikologu është eksperti që ka përgjegjësinë ligjore ekskluzive dhe detyrimin të shprehë mendimin e tij mbi rastin e ndjekur për të gjitha çështjet e tjera familjare të cilat kanë në qendër të miturin, marrjen në pyetje të tij nga

¹ Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”

gjykata apo influencën e mjedisit rrethues mbi psikikën, emocionet apo sjelljen dhe karakterin e tij. Mendimi i psikologut do të jetësojë vullnetin dhe dëshirat e të miturit në përputhje me interesin më të lartë të tij. Ky është edhe vetë thelbi i interesit të legjislatorit që kërkon të mbrojë të miturin, duke respektuar interesin e tij për një jetesë normale dhe dinjitoze.

Në rastin e pjesëmarrjes së të miturit në një proces ligjor penal, eksperti psikolog apo punonjës social nuk është përcaktuar në mënyrë taksative në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale², gjë e cila lejon dhe krijon hapësirën e nevojshme për të përvijuar në bazë të rolit dhe llojit të procedurës, se cili nga ata do të ishte më i përshtatshëm në kontekstin e dhënë, kjo në ndryshim nga Kodi i Familjes. Si një nga garancitë themelore të të drejtave të të miturit, asistimi i tij gjatë procesit të marrjes në pyetje në Komisarjat apo Prokurori nga një psikolog, si dhe gjatë momentit të dhënies së dëshmisë përpara Gjykatës nga një psikolog, ashtu edhe nga një punonjës social, lejon një formim e vlerësim psikologjik të të miturve sa më korrekt dhe real, ashtu edhe të situatës në të cilën ky i mitur ndodhet. Kjo lidhet ngushtë me kompetencat dhe ekspertizën që ofrojnë të dy ekspertët në shqyrtimin e rastit³, duke treguar domosdoshmërinë e prezencës së tyre në këtë moment tepër delikat për të miturin.

Duke kuptuar rëndësinë e rolit të psikologut në të gjitha fazat e hetimit dhe gjykimit si civil, ashtu dhe penal, lind nevoja për përfshirjen e tij në strukturat e sistemit gjyqësor, duke menduar që kjo mund të përmirësojë cilësinë e drejtësisë në vend. Kjo kërkesë është ngritur prej disa vitesh nga disa OJF, që veprojnë në fushën e shërbimeve ligjore falas për të miturit dhe gratë, të cilat e kanë evidentuar këtë si një problem për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Disa nga këto këndvështrime përcillen në vijimësi.

1. Legjislacioni shqiptar për pjesëmarrjen e psikologut në sistemin gjyqësor (Procesi civil e penal).

²Ligji Nr. 7950, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin Nr. 8460, datë 11.2.1999, me ligjin Nr. 8570, datë 20.1.2000, me ligjin Nr. 8602, datë 10.4.2000, me ligjin Nr. 8813, datë 13.6.2002, me ligjin 9085, datë 19.6.2005, me ligjin Nr. 9187, datë 12.2.2004, me ligjin Nr. 9276, datë 16.9.2004.

³Fushat e ekspertizës psikologjike dhe asaj sociale janë të ndryshme, kështu që dhe mendimi i dhënë nga ekspertët e secilës fushë është i ndryshëm por që i shërben në rastin tonë të njëjtit qëllim. Psikologjia është shkenca që studion proceset psikike, të ndërgjegjshme e të pandërgjegjshme, të njohjes (perceptimit, vëmendjes, memories, gjuhës, mendimit etj.) e dinamikë (emocionet, motivacionet, personalitetit etj.) Sociologjia është shkenca që ka për objekt fenomenet sociale të hetuara në shkaqet e tyre, manifestimet dhe efektet, në raportet reciproke dhe referuar evenimenteve të ndryshme. Burimi www.treccani.it

Figura e psikologut është e lidhur ngushtësisht me të miturin dhe prania e tij në të gjitha fazat e procedimit ligjor që ka në qendër të miturin përbën një detyrim ligjor. Ky detyrim vjen si pasojë e sanksionimit të tij në ligj dhe në respektim të të drejtës që ka çdo i mitur për t'u dëgjuar, kjo në varësi të moshës dhe të zhvillimit të tij intelektual.⁴ Për këtë arsye legjislatori sanksionon detyrimin ligjor të organit gjyqësor që në çdo rast kur ndërmer veprime ligjore të cilat kanë në qendër të tij të miturin duhet ti realizojë këto veprime i shoqëruar nga prania e psikologut. Veprime të tilla siç është marrja në pyetje nga ana e gjykatës/prokurorisë/policisë e të miturit është vlerësuar me rëndësi të veçantë për të ardhmen e tij nga ana e legjislatorit, prandaj është përkufizuar si një nga procedurat që kërkon praninë e ekspertit psikolog. Prania e këtij eksperti i jep më shumë mundësi dhe aftësi organit të drejtësisë apo atij të hetimit të deshifrojë e kuptojë të miturin, realitetin ku ky i mitur jeton dhe gjendjen në të cilën ai rritet dhe formohet. Ndërkohë që prezenca e punonjësit social apo sociologut nuk zbeh aspak rolin dhe figurën e psikologut të cilët në bashkëpunim mes tyre realizojnë një ekspertizë të plotë, të saktë dhe reale të situatës, ambientit dhe gjendjes ku rritet dhe formohet i mituri.

Në Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë, ndër parimet thelbësore⁵ të mishëruara prej tij parashikohet pasja në konsideratë parësore e interesit më të lartë të fëmijës nga prindërit, organet kompetente dhe gjykata, duke përcaktuar edhe detyrat konkrete për prindërit, Shtetin dhe shoqërinë. Në këtë kuadër, në respektim të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e Fëmijës” (neni 3), e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, dhe të nenit 54/1 Kushtetutës së Shqipërisë, legjislatori shpreh të gjithë gatishmërinë e tij për të realizuar këtë interes të të miturit përmes ndërthurjes së mekanizmave të tij. Në dispozitat specifike të KF përcaktohen shprehimisht rastet, kur është e domosdoshmërinë thirrja e psikologut dhe dhënia e vlerësimit të tij mbi gjendjen psikologjike të të miturit apo të situatës së tij sociale. Specifikisht, KF në

⁴Neni 6 Kodi i Familjes: “Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohe në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohe, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, përveç se për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar.

I mituri mund të dëgjohe vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij.

Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme, për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale.”

⁵Nenet 2 dhe 3 të Kodit të Familjes

nenin 155 të tij,⁶ përcakton që gjykata përpara se të shprehet me një vendim të përkohshëm apo përfundimtar mbi të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit bashkëshort, ka detyrimin të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili merr kontakt me të miturin dhe pasi dëgjon thëniet e tij apo merr të dhëna mbi gjendjen materiale dhe morale të fëmijës, jep vlerësimin mbi të ardhmen e të miturit. Në rastin e Zgjidhjes së Martesës, në përcaktimin se kujt nga prindërit do t'i lihet i mituri për rritje dhe edukim, gjykata në vendimin e saj merr në konsideratë mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore, gjithmonë pasi të kenë dëgjuar të miturin.⁷ Në rastin e vendosjes apo ndryshimit të kujdestarisë për të miturin apo personit që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar, gjykata në vendimin e saj udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit, duke u mbështetur në dhënien e vendimit të saj përfundimtar dhe në vlerësimin e rastit të bërë nga sektori i ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë Bashkisë së vendit ku zhvillohet procesi gjyqësor, në bazë të ekzaminimit të bërë prej tyre, të zhvillimit të fëmijës dhe të ambientit familjar ku ky fëmijë rritet dhe zhvillohet, si edhe të raporteve të krijuara mes të miturit dhe kujdestarit të tij.⁸ Në vendimin e saj, gjykata merr në konsideratë dhe dëgjon vlerësimin e psikologut, i cili është i pranishëm gjatë seancës së marrjes në pyetje të të miturit nga gjykata.⁹ Sipas këtij Kodi, me rëndësi të konsiderueshme

⁶Citohet konkretisht Neni 155 i KF: “Para se Gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija.

Në raste se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t’i besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi.”

⁷Neni 157 i Kodit të Familjes: “Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë:

a. Marrëveshjen e bërë ndërmjet ish- bashkëshortëve;

b. Mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij;

c. Mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën”.

⁸Neni 267, paragrafi 3, i Kodit të Familjes: “Gjykata, në çdo rast, merr mendimin e sektorit ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës së vendit ku zhvillohet gjykimi, i cili përmban ekzaminimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës në kontekstin familjar edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së fëmijës me personin kujdestar të ardhshëm, të familjes kujdestare ose institucionit të përkujdesjes”.

⁹Neni 267 paragrafi 4 Kodi i Familjes “Caktimi i kujdestarit nga Gjykata bëhet duke parë cilësitë e personit kujdestar, të familjes kujdestare të zgjedhur ose të institucionit të përkujdesjes, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, si dhe pasi ka dëgjuar mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit”.

Neni 273 paragrafi 3 Kodi i Familjes “Gjatë gjykimit duhet të dëgjohet dhe i mituri që ka mbushur moshën 10 vjeç, në praninë e psikologut”

është vlerësuar prania dhe vlerësimet e dhëna nga psikologu apo sektori i ndihmës dhe shërbimeve sociale në vendin ku zhvillohet gjykimi, edhe në rastet e *birësimin të të miturit, në rastet e vendosjes/kufizimit/pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore*¹⁰ në rastet e *administrimit, tjetërsimit apo të veprimeve të tjera juridike, të cilat cenojnë pasurinë e të miturit nga ana e prindërve apo kujdestarit të tij ligjor, që kërkojnë një autorizim nga gjykata*¹¹ apo në rastin e *lejimit të martesës nën moshën e përcaktuar në ligj (nën 18 vjeç)*.¹² Në këto raste, gjykata priret të respektojë dispozitat e nenit 6 të KF, që përcaktojnë praninë e detyrueshme të psikologut për vlerësimin e thënieve të të miturit në çdo procedurë ligjore të lidhur me të.

Roli i psikologut është shumë aktiv edhe në rastin e çështjeve ligjore, që kanë në objektin e tyre *dhunën në marrëdhëniet familjare*¹³. Duke qenë se legjislacioni shqiptar i ofron një garanci dhe mbështetje ligjore të miturit, nëpërmjet respektimit të të drejtave të tij për një jetë normale, të sigurt dhe të qetë, një familje të shëndoshë që kujdeset për mirëritjen, edukimin, zhvillimin, mirëqenien dhe arsimimin e tij, ai përcakton detyra specifike për Shtetin dhe shoqërinë me fokus sigurimin e të gjitha kushteve që bëjnë të mundur këtë mirëqenie dhe parandalojnë keqtrajtimin psikologjik, social, fizik, ekonomik etj, të fëmijëve në familje, në shkollë dhe në të gjitha ambientet e institucionet për të mitur. Në rastin e dhënies së vendimit për *caktimin e urdhrin të mbrojtjes për të miturit, caktimin e të drejtës së takimit të të miturit/viktimë e dhunës me prindin/ gjyshërit, heqja/kufizimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore kundrejt të miturit /viktimë e dhunës, kufizimin e kujdestarisë prindërore ndaj të miturit*, gjykata vendos pasi dëgjon vlerësimet e paraqitura nga psikologu, që është vënë në kontakt me të miturin dhe është njohur më nga afër me mendimet e tij. Po kështu, ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, krahas dëgjimit të mendimit të psikologut nga gjykata, përcaktimit psikologjik të personalitetit të të miturit, të problematikës së paraqitur nga i mituri apo situatës familjare të perceptuar prej tij, i jep edhe një vlerë të plotë provuese mbi provueshmërinë e situatës së dhunës. Të tilla vlerësime psikologjike të ofruara nga psikologë që kanë marrë kontakte me të miturin në momente të caktuara të jetës së tij (ku mund të jenë psikologët e shkollës, ata të qendrave sociale ose të Shërbimit Social

¹⁰Shiko nenet 223-224-226-228 të Kodit të Familjes

¹¹Shiko nenin 234 Kodi i Familjes

¹²Shiko nenin 7 të Kodit të Familjes

¹³Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, nr. 9669, datë 18.12.2006

Shtetëror, apo të institucioneve të tjera, si OJF, që kanë qenë në kontakt me të miturin), apo vlerësime/ekspertiza/deklarime/ekzaminime/pohime të ofruara nga punonjës social apo departamenti i shërbimeve sociale në njësinë e qeverisjes vendore, të cilat ndihmojnë gjykatën në krijimin e bindjes së saj gjatë hetimit gjyqësor, për të vërtetuar shkaqet, rrethanat dhe elementet e dhunës në familje, se si kjo dhunë ka prekur efektivisht të miturin, ka shkaktuar pasojën e ardhur apo si mund të ndikojë kjo dhunë në zhvillimin e personalitetit dhe mirërritjes së tij në të ardhmen.¹⁴

Përfshirja e të miturit në *procesin penal* kërkon në të njëjtën kohë dhe asistimin e tij nga psikologu, asistim që gjen bazën e tij ligjore në *Kodin e Procedurës Penale*, siç është rasti i *arrestimit dhe ndalimit të të miturit; shoqërimit në rast flagrante të të miturit në ambientet e komisariateve të policisë; kontrollit të të miturit apo marrjes në pyetje të të miturit (në polici, prokurori, gjykatë) gjatë të gjitha fazave e procesit hetimor dhe gjyqësor penal*. Ky Kod përcakton shprehimisht, krahas sigurimit të ndihmës juridike për të miturin të marrë si të pandehur, edhe atë psikologjike në çdo fazë dhe shkallë të procedimit, ndihmë e cila jepet nëpërmjet pranisë së psikologut gjatë dhënies së deklarimeve ose përpilimit të akteve apo kryerjes së veprimeve që lidhen me të miturin¹⁵ (neni 35 K.Pr.P). Gjatë hetimit gjyqësor, organi procedues dëgjon mendimin e psikologut apo të ekspertëve të cilët nëpërmjet marrëdhënieve që kanë patur me të mitur bëjnë të mundur të vlerësojnë gjendjen e tij psikologjike, familjare shoqërore dhe kushtet e tij të jetesës duke shpjeguar kështu dhe rrethanat e faktet të cilat mund ti vijnë në ndihmë të miturit dhe vetë çështjes. Ky mendim ka një rëndësi të veçantë pasi ndikon drejtpërsëdrejti në orientimin dhe krijimin e bindjes, hedhin baza për hetimin e mëtejshëm nga organet e Policisë Gjyqësore ose Prokurori apo dhënies së gjykimit nga ana e gjykatës, sigurimit të provave apo formulimit të rrethanave lehtësuese ose krijimit të profilit psikologjik të të miturit duke përcaktuar dhe masat konkrete e të përshtatshme të

¹⁴Neni 15-16 i ligjit “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”

¹⁵Neni 35 K.Pr.P.: Ndihma që i jepet të pandehurit të mitur “1. Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.
2. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin e I, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit”.

dënimit penal¹⁶ (neni 42 K.Pr.P). Në rastin e pyetjes së të miturit dëshmitar nga organet e proceduese dhe gjykata, Kodi i Pr. Penale përcakton si shumë të rëndësishëm praninë e ekspertit psikolog duke dashur kështu të mbrojtë të miturin duke mos dëmtuar gjendjen e tij psikologjike dhe emocionale¹⁷ (neni 361/pika 5).

Duke marrë shkas nga kjo panoramë e legjislacionit civil e penal që ofron mbrojtje dhe garanci të të drejtave të të miturit nëpërmjet përkujdesjes për shëndetin dhe gjendjen e tij sociale, psikologjike, emocionale dhe familjare me asistimin nga ekspertë në fushën e shërbimeve për të miturit, kërkohet me/në të gjitha mënyrat të eliminohen në maksimum të gjitha ndikimet dhe perceptimet negative që një procedim civil, penal e administrativ mund të ketë mbi psikikën e tij, kërkohet ti vihet në ndihmë familjes në zbulimin dhe kuptimin e rrethanave dhe shkaqeve reale në të cilat ndodhet i mituri, organeve kompetente (polici, prokurori, gjykatë) në arritjen e të vërtetës ligjore nëpërmjet zbrërthimit sa më të drejtë të çështjes dhe vetë shoqërisë në investimin dhe ofrimin e shërbimeve konkrete dhe korrekte për të miturit si pjesë e të ardhmes së saj.

2. Roli i ekspertit psikolog në procesin gjyqësor për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Mundësia që legjislacioni (civil dhe penal) i jep të miturit për të qenë pjesë aktive për t'u dëgjuar në çdo procedure ligjore ku ai është subjekt, pa kufizim moshe, realizohet në mënyrën e duhur dhe në shërbim të interesit më të lartë të tij, me praninë dhe mbështetjen e psikologut apo punonjësit social/sociolog. Me ndërhyrjen e tij, psikologu, në rolin e ekspertit profesionist në çështjet familjare e të të miturve, kërkon t'i vijë në ndihmë procesit gjyqësor duke përbërë një garanci për mbarëvajtjen e tij dhe të respektimit të të drejtave të të miturit dhe të të gjitha palëve të përfshira në

¹⁶Neni 42 K.Pr.P.: **Verifikime për personalitetin e të pandehurit të mitur** “1. Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare, dhe shoqërore të të pandehurit të mitur, me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit, si dhe të caktojë masa të përshtatshme penale.

2. Organi procedues mbledh informacione nga personat që kanë pasur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve.”

¹⁷Neni 361 (pika 5):“Pyetja e dëshmitarit të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2. Urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes.”

proces. Eksperti¹⁸ psikolog për shkak të cilësive të tija profesionale thirret nga gjykata me qëllim dhënien e një vlerësimi korrekt dhe konkret të *personalitetit të të miturit brenda dinamikës së një situatë familjare, realizon të ashtuquajturin bashkëbisedim klinik dhe bën rekomandime për gjykatën. Para se të japë mendimin, psikologu duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija. Ai deshifron një mendim, sjellje, reagim ose tërheqje të një fëmije që po përjeton një situatë të re, jonormale, ose traumatike.*

Ky angazhim i ekspertit psikolog ose punonjës social/sociolog, i vjen në ndihmë gjykatës për ekzaminimin e mendimit të fëmijës, i cili mund të jetë nën trysinë e një situatë familjare traumatike dhe konfliktuale që arrihet të zbulohet dhe kuptohet nga gjykata vetëm nëpërmjet ndërhyrjes së psikologut. Gjatë hetimit gjyqësor, prokurorëve, gjyqtarëve apo policëve gjyqësore i mungojnë njohuritë e duhura për të kuptuar e deshifruar gjendjen psikologjike të të miturit apo të formulojnë drejt pyetjet që do ti drejtojnë atij për të vlerësuar siç duhet informacionin e marrë nga fëmija. Për këtë arsye ata thërrasin në ndihmë mendimin e ekspertit psikolog. Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë “*evidentohet se në kuptim të neneve 6, 155 dhe 157 të Kodit të Familjes, për rastet e gjykimit të çështjeve familjare të kësaj natyre, roli dhe veprimet e psikologut shikohen në dy dimensione. Së pari, ai interpreton thëniet e fëmijës, në të gjitha rastet kur fëmija dëgjohet në gjykim. Sipas pikës 3 të nenit 6, interpretimi i thënieve nga ky ekspert, është veprim i detyrueshëm dhe jo fakultativ për gjykatën. Së dyti, psikologu apo punonjësi social, bazuar në anketën sociale ezauruese, të hollësishme dhe të plotë të zhvilluar prej tij në lidhje me gjendjen materiale të secilit prind, kushtet në të cilat jetojnë, profilin moral të secilit dhe të fëmijës, jep vlerësimin personal se cili nga prindërit konsiderohet më i përshtatshëm për t’iu besuar fëmija. Në çdo rast, opinioni i psikologut apo punonjësit social është orientues për gjykatën. Çdo konkluzion i kundërt i gjykatës ndaj këtij opinioni, duhet të jetë i argumentuar.*¹⁹

Argumentimi i vendimit të gjykatës në çdo moment duhet të jetë në respektim të parimit të “*interesit më të lartë të fëmijës*”, që realizohet rast pas rast, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Prandaj “*është e nevojshme që gjykata të vlerësojë siç*

¹⁸Ekspertimi si veprimtari për vërtetimin e fakteve kontestuese, zhvillohet nga eksperti i cili caktohet me vendim të organit procedues (gjykatës) dhe rezulton me dhënien e mendimit nga ana e tij

¹⁹Vendimi nr.357, datë 11.09.2008 i Gjykatës së Lartë

duhet interesin më të lartë të fëmijës në raport me mundësitë materiale të prindërve, të mundësive të zhvillimit fizik, moral e intelektual të fëmijës, të pjekurisë së tij në konceptimin e situatës dhe të zgjidhjeve që ai shpreh nëpërmjet mendimit të tij”. Kjo kërkon nga Gjykata “një analizim të mirëfilltë të të gjithë elementëve dhe faktorëve që kanë të bëjnë me rritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin, arsimimin të përfuturuar gjatë hetimit gjyqësor si dhe nëpërmjet vlerësimit të përfutur nga specialisti për gjendjen psikologjike dhe familjare të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë mund të thuhet që gjykata në mënyrë eksplicite ka argumentuar çdo aspekt të këtyre konsideratave dhe ka realizuar interesin më të lartë të fëmijës”²⁰

Psikologu, thirret gjithmonë në procedurat me subjekt të miturin i cili në bazë të parimit të dëgjimit, të marrjes pjesë së fëmijës dhe të konsiderimit të mendimit të tij në çdo procedurë, të lidhur me të apo ku ka një interes për të ndërhyrë në proces, realizon të gjitha detyrat e ngarkuara nga organet kompetente për nxjerrë në pah të vërtetën. Nëpërmjet teknikave të pyetjeve, lojërave, tregimeve, psikologu arrin të perceptojë mendimet e fëmijës dhe ti deshifrojë ato në gjuhën e të rriturve, duke ndihmuar fëmijën të shprehë mendimin për çështjen që gjykohet/hetohet dhe ti ofrojë gjykatës një vlerësim sa më të drejtë të mendimit të fëmijës në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar. Në përputhje me personalitetin e fëmijës, “*psikologu paraqet mendimet e tij, ëndrrat, dëshirat e nevojat e tij në mënyrë objektive, duke mos nxjerrë përfundime që prekin çështjen në gjykim por vetëm analizon thëniet e të miturit sipas moshës së tij, zhvillimit mendor dhe situatës në të cilën ndodhet fëmija. Ai bën vlerësimin e personalitetit të të miturit brenda dinamikës së situatës familjare, realizon të ashtuquajturin bashkëbisedimin klinik dhe bën rekomandime për gjykatën*”.²¹

Ky angazhim i detyruar i psikologut në çdo procedurë ligjore që ka në qendër të miturin e ku merren vendime që ndikojnë në jetën e tij, nëpërmjet vlerësimit të thënieve të veta janë shprehje e qartë e rëndësisë së figurës së psikologut.

Hetimet e psikologut mbi personalitetin dhe ambientin ku i mituri rritet dhe zhvillohet kërkojnë ndërhyrje mbështetëse sipas nevojave të rasteve konkrete të përcaktuara nga strukturat të cilat kanë shqyrtuar rastin. Psikologu nëpërmjet ndërhyrjes së tij realizon një marrëdhënie me të miturin shumë të thellë, marrëdhënie

²⁰Vendimi nr.357, datë 11.09.2008 i Gjykatës së Lartë

²¹Arta Mandro “E drejta Familjare”, Emal, Nëntor 2009, faqe 71

e cila bazohet në takimet e shpeshta e jo të vetme, të papërcaktuara në kohë gjatë gjithë kohëvazhdimet të hetimit gjyqësor apo procedimit sipas rastit, duke realizuar kështu një monitorim sistematik që do ti vijë në ndihmë atij për zbërthimin e çështjes. Në respektim të detyrave të caktuara ndaj tij, psikologu dhe pse është një figurë profesionale që ofron mbështetje veçanërisht në një moment të vështirë, udhëhiqet nga parimi ti shërbejë vendosjes së drejtësisë duke shfrytëzuar marrëdhënien e krijuar me të miturin. I tillë është rasti i të miturit adoleshent të përfshirë në episode dhune të karakterizuara nga kërkimi i vazhdueshëm i identitetit të tij, me nevojën për të pasur një pikë referimi jashtë ambientit të tij familjar të cilit të mund ti drejtohet. Kapaciteti i psikologut për të perceptuar dhe kuptuar dinamikat dhe mekanizmat psikike të të miturit që i krijon mundësinë të interpretojë sjelljet dhe pse me raste kontradiktore, e bëjnë atë shumë të rëndësishëm dhe një pikë referimi për të miturin. Kjo gjë i krijon mundësinë psikologut të propozojë modifikime dhe masa që të rezultojnë sa më efikase për të miturin. Të tilla masa i vijnë në ndihmë të miturit, duke eliminuar një mundësi të tij për t'u bërë recidivist në të ardhmen apo të krijojë probleme për shoqërinë. Ky rrugëtim dhe evolucion pozitiv i krijon mundësi të miturit që në momentet e vështira të mos tentohet ta braktisë atë duke u udhëhequr nga shembujt pozitive të injektuar nga kontakti me ekspertët profesionistë. Pikërisht një ndjekje e rregullt e të miturit gjatë dhe pas procedimit penal i lejon psikologut të njohë më mirë të miturin në përputhje me kompetencat dhe funksionet e tij. Në këtë mënyrë psikologu gjyqësor me një veprim shumë aktiv në fushën e të miturve, të së drejtës familjare dhe të dhunës në familje, ka marrë një dimension të ri në situatat juridike të lidhura me problemet e integritetit psikologjik individual (dëmi biologjik psikologjik dhe ekzistencial), me garantimin e kushteve specifike për zhvillimin psiko-fizik të të miturit (të së drejtës familjare, birësimit, kujdestarisë) e deri në kushtet e riedukimit apo risocializimit (në fushën penale dhe regjimin e burgjeve). Si pasojë e zhvillimeve sociale dhe politike, Shteti gjithmonë ka kërkuar të ruajë dhe mbrojë kontekstin familjar dhe evolucionin moshor të individit nëpërmjet strukturave sociale publike e private, legjisllacionit dhe planeve të veprimit duke treguar një kujdes për integritetin familjar dhe ruajtjen e autenticitetit e saj dhe në respektim të dinjitetit njerëzor edhe kur kemi të bëjmë me një të mitur të dënuar.

3. Organizimi i shërbimit të ekspertizës së psikologut/punonjësit social. Përvoja e Shqipërisë.

Çdo person i cili plotëson kushtet dhe kriteret kualifikuese për të ushtruar detyrën e psikologut gjyqësor i drejtohet zyrës së burimeve njerëzore në gjykatë ose zyrës së kancelarisë e cila pasi mbledh dokumentet ia përcjell Kryetarit të Gjykatës. Është Kryetari i Gjykatës ai që, pasi shqyrton aplikimet e paraqitura, duhet të vendosë se cilët prej këtyre ekspertëve plotësojnë kushtet për të qenë në rolin e ekspertit “psikolog gjyqësor”. Pra, Kryetari i gjykatës duhet të bënte vetëm publikimin e listës së psikologëve, të cilët praktikisht, zgjidhen nga gjyqtarët, të cilët shqyrtojnë çështjet konkrete, në respektim të parimit të pavarësisë të gjyqtarëve gjatë gjykimit të çështjes.

Nëqoftëse do t'i referohemi Udhëzimit KM Nr. 4, datë 12.12.2012 *“Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*, aty parashikohet konkretisht në pjesën e dispozitave të përgjithshme, masa e shpenzimeve të dëshmitarëve dhe pagesës së ekspertëve pjesëmarrës në seancat gjyqësore, duke theksuar se *“Çdo vit, gjykata e rrethit gjyqësor publikon listën e ekspertëve të licencuar dhe përditëson listën, në rastet kur autoritetet licencuese marrin masa administrative të pezullimit të licencës. Është gjykata që thërret ekspertë të licencuar, të përcaktuar në listën që ajo disponon. Në rast se në listë nuk figurojnë ekspertë në fushën e kërkuar ose kur asnjë nga ekspertët që figuron në listë nuk është i disponueshëm, Gjykata thërret ekspertë të tjerë, referuar veçantisë së fushës së kërkuar”*. Megjithatë, duhet të mbahet parasysh fakti se psikologët dhe punonjësit socialë nuk mund të barasvlerësohen me ekspertët e tjerë që mund të thirren nga gjykata. Ata thirren në mënyrë të detyrueshme dhe lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Deri tani, pavarësisht nga sa më sipër, Psikologu/punonjësi social në organet e drejtësisë, mbetet ekspert i jashtëm. Si ekspert i jashtëm psikologu kërkohet dhe thirret nga gjyqtari i çështjes. Aktualisht, jo të gjitha gjykatat kanë një listë paraprake të psikologëve, prandaj ligjërisht janë të hapura mundësitë për të gjithë psikologët/punonjësit socialë që kanë Diplomë Bachelor për Psikologji/Punë social edhe Diplomën Master për këto degë të përfaqësojnë klientin duke paraqitur raportin e vlerësimit para gjykatës. Në fakt, lipset pajisja e ekspertit me licencën përkatëse të lëshuar nga organi kompetent, Ministria përkatëse (ajo e Mirëqenies Sociale, ose Ajo e Drejtësisë, gjë që vlen të shikohet se si do të zgjidhet në të ardhmen, duke plotësuar vakuumin procedural në mirëfunksionimin e ekspertit psikolog). Por fakt është që në

raste të tjera ekspertët të cilët ofrojnë shërbimet e tyre në gjykatë/prokurori/polici, janë të licencuar nga një organ kompetent që njih dhe garanton kapacitetin dhe vlerat profesionale të ekspertit (Ministria e Transporteve, e Ekonomisë, e Arsimit etj), gjë që nuk realizohet në rastin e ekspertit psikolog.

Gjyqtari në rastet kur çmon se duhet të marrë mendimin e psikologut dhe punonjësit social, e lidh këtë me kompleksitetin e çështjes dhe me nevojën e një mendimi shumë të specializuar. Në disa nga çështjet²² e mbështetura nga QNL, rezulton se vlerësimi psikologjik është përgatitur nga një skuadër e përbërë nga një psikolog klinik dhe një punonjës social. Mendojmë se kjo është një praktikë e mirë, me qëllim vlerësim sa më të plotë të rastit. Gjykata ka thirrur një psikolog klinikist dhe një punonjës social, me qëllim që psikologu të vlerësojë zhvillimin psiko-emocional të fëmijës, të prindërve, nivelin e atashimit afektiv të fëmijës me secilin prej prindërve, kurse punonjësi social të vlerësojë kushtet social ekonomike që ofron secili prej prindërve për mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe ku është më e përshtatshme të qëndrojë fëmija. Kjo situatë rrit cilësinë e punës së ekspertëve të jashtëm të gjykatës, por njëkohësisht rrit mjaft edhe shpenzimet për palët. Prandaj është e nevojshme të bëjmë një vlerësim aktual të situatës së angazhimit të psikologëve dhe rezultateve të tyre për mbrojtjen e fëmijëve, marrëdhëniet familjare etj. Për këtë u drejtuam në disa përvoja të evidentuara nga qendrat që ofrojnë shërbime falas, konkretisht, TLAS dhe QNL.

4. Përvoja e qendrave që ofrojnë shërbim ligjor falas, (QNL, TLAS), në identifikimin e problematikave në ekspertizën e psikologut/punonjësit social ndaj fëmijëve dhe palëve ndërgjyqëse.

Për identifikimin e problematikave në ekspertizën e psikologut/punonjësit social ndaj fëmijëve dhe palëve ndërgjyqëse, TLAS angazhoi një psikologe dhe një avokate të cilët u përqendruan kryesisht, në praktikën e ndjekur dhe eksperiencën me rastet e klientëve të trajtuara nga ky shërbim ligjor falas. Sigurisht, qëllimi i këtij studimi modest është të evidentojë disa nga metodat e taktikat e hartimit të raporteve vlerësuese nga psikologët, të theksojë rolin e rëndësishëm të këtij eksperti por edhe të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre në të mirë të interesit më të lartë të fëmijës/ve dhe familjeve kujdestare.

²²Raport psiko social, datë 22.4.2014 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me palë E.R k. V.P.

Një përcaktim për përgatitjen e raporteve të vlerësimit ofrohet nga udhëzuesi I publikuar për këtë qëllim që shërben si udhërrëfyes e model për armatën e psikologëve e punonjësve socialë, I bazuar në Kodin e Familjes dhe ato të procedurës penale dhe civile, ku theksohet në mënyrë të veçantë se këta profesionistë duhet të kenë aftësi të mira komunikimi dhe njohuri të veçanta mbi Psikologjinë Ligjore dhe elementët psikologjikë të procesit të marrjes në pyetje dhe atij të rrëfimit. Padyshim, sa më shumë thellohesh në procesin e njohjes së këndvështrimeve të psikologëve dhe përkatësisë gjinore apo fëmijëve përvijohet fakti që roli i psikologut është i rëndësishëm sepse ai ofron dhe duhet të ofrojë një shërbim sa konfidencial, aq edhe të paanshëm përmes sigurimit të informacionit objektiv dhe kompetent në procesin e vlerësimit të interesave të fëmijës/ve dhe palëve ndërgjyqëse.

TLAS dhe QNL në procesin e rasteve gjyqësore ndeshen me disa kategori apo lloje çështjesh ku gjyqtari/ja kërkon ekspertizën e psikologut përpara se të marrë vendimin gjyqësor. Më të shpeshta në TLAS dhe QNL kanë qenë rastet që vijnë:

- a) gjate procesit të një zgjidhjeje martese (divorci),
- b) procesit të heqjes së përgjegjësisë prindërore kur e drejta prindërore është e ezuarur,
- c) gjate procesit të caktimit të kujdestarit të fëmijës apo fëmijëve në rastet e braktisjes, abuzimit apo neglizhimit,
- d) në rastet e urdhrit të mbrojtjes
- e) Vlerësimit të dëmit psikologjik.

Bazuar në eksperiencën e rasteve të përfaqësuara në gjykatë nga TLAS në rrethet Tiranë, Elbasan, Fier, Durrës, Krujë dhe Lezhë, gjate 5 viteve të fundit,²³ mund të pasqyrojmë numrin e çështjeve të trajtuara, pjesëmarrjen e psikologut me raporte vlerësuese në procesin gjyqësor dhe sigurisht, punën me palët ndërgjyqëse dhe fëmijët e tyre si më poshtë:

²³Të dhënat kanë si burim data bazën e TLAS, shume profesionale në fushën e shërbimeve ligjore, e instaluar nga John Camps, USA, që në vitin 2000. Puna me klientet, avokatet, psikologët apo eksperte të tjerë është e pasqyruar në kohe dhe me detaje për secilin vit, çështje, me të dhëna personale për klientin, adresën, kontaktet dhe rezultatin e mbylljes së rastit.

| Nr | Viti | Zgjidhje Martese | Kujdestari | Përgjegjësi Prindërore | Psikolog i përgjithshëm | Punonjës social |
|--------------|---------------------------|------------------|------------|------------------------|-------------------------|-----------------|
| 1 | 2010 | 96 | 76 | 13 | 95% | 5% |
| 2 | 2011 | 153 | 87 | 21 | 93% | 7% |
| 3 | 2012 | 113 | 56 | 24 | 94% | 6% |
| 4 | 2013 | 135 | 66 | 28 | 94% | 6% |
| 5 | 1 Janar - 30 Shtator 2014 | 137 | 50 | 17 | 98% | 2% |
| total | 1072 | 634 | 335 | 103 | 95% | 5% |

Tabela tregon se, TLAS ka grumbulluar një eksperiencë të gjerë për të gjitha rastet e mësipërme ku roli i psikologut dhe raporti i tij i vlerësimit është kërkuar nga gjykata me synimin e sigurimit të një kujdesi sa më të mirë ndaj fëmijës/ve I pa shkëputur edhe nga këndvështrimi gjinor.

Për të qenë sa më konkret e përgjithësues në të njëjtën kohë, u angazhuan një psikologe dhe një avokate e TLAS të studiojnë rreth punës së dhe rolit të psikologut mbi bazën e një Sampli të përbërë nga 50 raportesh vlerësuese që u takojnë 50 rasteve të përmendura në tabelë, me karakteristika dhe individualitet të ndryshëm nga njëri tjetri si, këto të hartuara nga 10 psikologë të ndryshëm, 4 prej të cilëve angazhohen në gjykatën e shkallës së parë në Tiranë, dhe 6 të tjerët në gjykatat e shkallës së parë në Durrës, Fier, Elbasan, Lezhe dhe Krujë. Në Sampleu parashikuan disa intervista me palë ndërgjyqëse që aktualisht kanë rastet e tyre të përfaqësuar nga avokatët e zyrës. Raportet Vlerësuese të përzgjedhura, kopjet e të cilëve janë të depozituara në arkivin e TLAS, u shqyrtuan me vëmendje duke u bazuar në drejtimitet e përcaktuara që më parë si:

- Sa ka arritur psikologu te demonstroje gjithmonë qëllimin e qarte dhe te ndjeshëm ne procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të fëmijës/ve
- Si dhe sa e ka argumentuar rolin e sjelljen e secilit prind
- Sa vëmendje I kushtohet sqarimit me detajet e nevojshme të palëve në proces për natyrën dhe qëllimin e vlerësimit
- A ka patur raste të keq përdorimit të influencës së psikologut që meritojnë të përmenden
- Shkalla e diversitetit të raporteve të vlerësimit nga psikologë të njëjtë dhe të ndryshëm për çështje të njëjta e të ndryshme
- Roli i kualifikimit apo nivelit profesional si vlere e shtuar ne cilësinë e raportit të vlerësimit dhe në ndikimin apo influencën për marrjen e një vendimi gjyqësor ne favor te interes me te larte te fëmijës.

Aktualisht, mungon një udhëzim apo urdhër i përcaktuar qartë e i miratuar për mënyrën e caktimit të psikologut, për shkallën e kualifikimit të tyre dhe për punonjësin social po ashtu. Nga praktika e deri tanishme Fakulteti i shkencave Sociale përgatit psikologë të përgjithshëm të cilët mund të jenë të specializuar për: Këshillim Psikologjik; Psikologji Sociale; dhe nuk ofron përgatitjen e duhur që psikologu të jetë i trajnuar apo kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Një psikolog i angazhuar në organet e drejtësisë duhet pasi të ketë përfunduar arsimin e lartë për Psikologji të përgjithshme të specializohet në Psikologji Ligjore apo Psikologji Klinike, në mënyrë që të ofrojnë produkte më cilësore bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Është më e lehtë për një psikolog që punon në organet e drejtësisë të dallojë në palët ndërgjyqëse ata që vuajnë nga problematika mendore apo çrregullime të personalitetit, ose manipulues apo individualist egoist dhe që si rezultat do të pasqyrojë këto në hartimin e një raporti vlerësues të vlefshëm dhe të dobishëm për fëmijën/ët.

Nga intervistat me palët ndërgjyqëse dhe praktikantët e sotme para dyerve të gjykatave²⁴ pjesa më e madhe e psikologëve nuk kanë zyra apo ambiente të përshtatshme për të ndjekur të gjitha procedurat apo plotësuar kërkesat e gjykatës lidhur me hartimin e

²⁴Ky fenomen i ka ndodhur edhe avokateve te TLAS ne rastet kur çështja gjyqësore është ne rrethe te tjera te vendit jashtë Tiranës ku Zyra e TLAS siguron kushtet me te mira për punën e psikologut me fëmijët dhe palët.

Raportit të Vlerësimit. Kryesisht psikologët i kryejnë takimet me palët ndërgjyqëse në ambiente publike si: Bare, Lokale, Ambientet e Gjykatës, ose ambiente të tjera të papërshtatshme dhe që cenojnë parimin bazë të vlerësimit atë konfidencialitet. Që nga ky moment cilësia e raportit të vlerësimit që Psikologu do të “dorëzojë” tek gjyqtari / ja e çështjes është i diskutueshëm dhe jo rrallë i pavlefshëm.

Disa arsye janë:

Palët ndërgjyqëse përballen me praninë e personave të tjerë të cilët e cenojnë seriozitetin dhe besueshmërinë e procesit. Shkalla e transparencës dhe e sinqeritetit të palëve është e ndikuar detyrimisht nga ambienti që i rrethon. Ata individë objekt i intervistave që janë timidë ose të turpshëm apo të mbyllur si karaktere, nuk arrijnë të shprehin ç’ka ndjejnë sepse hutohen ose çoroditen, ndërsa ata që janë tinëzarë përfitojnë nga rasti për të aplikuar teknikat e manipulimit apo të shtirjes. Po ashtu zhurmat e ambientit rrethues e degradojnë intervistën në një bisedë të zakonshme, bisedë “kafeje”, shumë larg teknikave të domosdoshme profesionale.

Palët dhe fëmijët e interesuar për raportin e vlerësimit, Psikologu po ashtu, nuk ka si të ndihen rehat në ambientet publike të papërshtatshme. Por ata duket sikur po vazhdojnë të bëjnë një punë jo serioze. Procesi në këto raste, është më shumë një formalitet për palët, psikologun, gjyqtarin që detyrimisht në bazë të ligjit duhet të arkivojë raportin e vlerësimit por është po ashtu edhe një burim i lehtë financiar për psikologët, mungesë profesionalizmi nga ana e tyre dhe barrë financiare e rëndë për palët me të cilat merret shërbimi ligjor falas. Dihet që pagesa e psikologut si ekspert i jashtëm, mbulohet nga pala e cila ka ngritur padinë në gjykatë dhe psikologët i referohen udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë për pagesën e ekspertit, maksimumi i të cilit është 40000 lekë. Pothuaj të gjithë psikologët, pavarësisht nga koha apo cilësia e punës që bëjnë tentojnë të kërkojnë maksimumin e vlerës duke iu referuar udhëzimit nr 4, datë 12.12.2012, të qeverisë, dhe sigurisht duke gjetur mbështetjen e gjyqtarit/es. Dihet që nëse palët ndërgjyqëse merren vesh me njëri tjetrin për kërkesat ndaj fëmijës, raporti vlerësues i psikologut mund të shmanget, gjë që nuk aplikohet nga gjykata.

Ka patur jo rrallë raste, kur palët e interesuara për një raport vlerësues cilësor kërkojnë takime të posaçme me psikologun, adresa e zyrës se të cilit nuk gjendet, apo telefoni nuk hapet, apo e-maili nuk ofrohet.

Në disa raste psikologët nuk kanë vlerësuar situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe përpiqen të justifikojnë mendimin e tyre vetëm duke u bazuar tek situatat ekonomike të bashkëshortëve, pa marrë fare parasysh se çfarë pasojash ka sjellë dhuna në marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve. Kështu, po ilustruam një rast të parashtruar nga praktika e QNL si vijon:

- *Në vlerësimin psikologjik të psikologes D.B, megjithëse në historikun e shkurtër të rastit përmenden pohimet e paditëses në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj saj nga bashkëshorti, mungon analiza e efekteve që ka sjellë kjo dhunë në marrëdhëniet mes bashkëshortëve si edhe në marrëdhëniet e prindërve me fëmijët. Megjithëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.806, datë 24.02.2014 ka lëshuar UM në favor të paditëses F.M, psikologja nuk i referohet aspak në vlerësimin e saj të datës 11.3.2014, këtij UM. Rekomandimin e saj drejtuar Gjykatës në lidhje me lënien e dy fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim paditëses F.M, psikologja e ka lidhur me përkujdesjen e nënës, atashimin e saj të shëndetshëm me fëmijët, cilësitë e saj. Mendoj se në një vlerësim të tillë, psikologja duhet të kishte shprehur qartë faktin, se i padituri, dhunës ndaj F.M. nuk është prindi i përshtatshëm për t'ju lënë fëmijët për rritje dhe edukim. Psikologja ka rekomanduar që takimet e të atit me fëmijët të zhvillohen shpesh, pa u ndalur në faktin se i ati i fëmijëve është i dhunshëm, nevojën për takime të mbikëqyrura, etj²⁵.*

Nga veprimtaria e QNL dhe TLAs janë evidentuar edhe probleme të tjera që lidhen me probleme të raporteve psikologjike në qasjen ndaj parimit të barazisë gjinore. Në një rast tjetër të ndjekur nga QNL konstatojmë sa vijon:

Në raportin vlerësues²⁶ të psikologes M.B. dhe punonjëses sociale E.R., për çështjen me palë E.R. dhe V.P, me objekt “ Ndryshimin e vendimit civil nr.461, datë 4.6.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijën A.R., fakti që nëna e fëmijës është një viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore që përfiton nga shërbimet e ofruara nga qendrat e

²⁵Vlerësim psikologjik i psikologes D.B., datë 11.03.2014, për çështjen me palë F.M/AM me objekt zgjidhje martesë dhe caktimi i kujdestarisë prindërore.

²⁶Raport psiko social, datë 22.4.2014 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit ose viktimave të mundshme të trafikimit, është përdorur në vlerësim, si një arsye për të cilën nuk mund t'i lihet nënës fëmija për rritje dhe edukim. Shprehja nga vlerësimi se, “ ..aktualisht e paditura është në kushtet ku vetë ajo duhet të rehabilitohet, përshtatet dhe të integrohet në një mjedis të ri, pas situatave të vështira jetësore që ka kaluar..”. tregon sa e nevojshme është që psikologët dhe punonjësit socialë të trajnohen në vazhdimësi, në lidhje me çështje të dhunës me bazë gjinore si dhuna në marrëdhëniet familjare, trafikimi i qenieve njerëzore, etj. Mendoj se lënia e fëmijës nënës do të ndihmonte në rehabilitimin e saj krahas faktit që nëna është punësuar me mbështetjen e OJF-ve dhe masave të tjera rehabilituese të Qendrës “Të ndryshëm dhe të Barabartë”. Këtë qëndrim psikologja dhe punonjësjat sociale e shprehën edhe në faktin se, vendosën që babai ofron kushtet më të mira materiale dhe morale për fëmijën bazuar vetëm në një intervistë nëpërmjet skype-it me babanë.

Disa gjetje nga përvojat e qendrave QNL e TLAS që japin shërbim ligjor falas, në gjykatë.

- Në përgjithësi, raportet karakterizohen nga e njëjta skemë dhe qëllim i vlerësimit, ku përfshihen: përcaktimi i faktorëve individuale dhe familjare që ndikojnë interesat më të mira të fëmijës/ve, përcaktimi i faktorëve që do të sigurojnë mirëqenien e tyre, përcaktimi i kapacitetit prindëror në kontekstin e perspektivës së kujdestarisë si dhe përcaktimi i nevojave dhe dëshirave të çdo fëmije.
- Rreth 15 % e Psikologëve përpiqen të sigurojnë informacionin më specifik për gjykatën. Raportet e tyre janë më të dobishme dhe më influencuese sepse pasqyrojnë të dhënat reale, të duhura, mangësitë, vlerat dhe tendencat e prindërimit dhe specifikuisht nevojat psikologjike të fëmijës.
- Rreth 75 % e psikologëve del se nuk thellohen në vlerësimet e tyre, ose ata ofrojnë thjesht një tablo të situatës apo shkaqeve pa tentuar të rendisin pasojat që do të rezultojnë në këtë kontekst. Logjikisht dhe krahasimisht këto lloj raportesh vlerësuese duhet të kenë më pak peshë ose të mos influencojnë si duhet në vendimet e gjykatës. Në këto raporte vlerësuese del qartë që psikologu rrallë i referohet procedurave apo standardeve ligjore të aplikuara përfshi legjisllacionin përkatës të rastit.

- Duke qenë se rastet që janë studiuar i përkasin familjeve më vulnerabël të shoqërisë dhe kryesisht i komunitetit Rome dhe Egjiptian duhet theksuar se Psikologet duhet te jene te më të ndërgjegjshëm për te aplikuar praktika jo diskriminuese e jo paragjykuese për moshën, racën, etnitetin, origjinën, paaftësinë, gjuhën, kulturën apo statusin socio-ekonomik, për të ndërhyrë më ndjeshëm në objektivat e vlerësimit dhe ne rekomandimin para vendim marrjes.
- Ka raste kur në raportet e vlerësimit nuk pasqyrohen detaje të rëndësishme të aftësive të fëmijëve si ato konjitive, sjellore, mendore apo sociale. Nga studimi del se vlerësimet mendore, shtrembërimet konjitive, prania ose mos prania e deluzioneve apo çrregullimeve të ankthit, stresit, gjendjeve emocionale, konceptimeve të deformuara, etj. nuk merren në konsideratë ose bëhen të cinguara , të pa argumentuara apo adresuara.
- Një gjetje tjetër gjetje e studimit të raporteve vlerësuese lidhet me të ashtuquajturin Ekzaminimin e Statusit Mendor të palëve , ose ESM, si një nga procedurat profesionale që psikologu ka detyrimin të përcaktojë. Me sa duket vlerësimi e elementëve që përmban ESM është i vështirë dhe shumica e Psikologëve, duket sikur përsërit të njëjtën situatë, ndryshojnë vetëm emrat e palëve ndërgjyqëse dhe tek tuk ndonjë fjalë.
- Në më shumë se 60 % të raporteve të studiuara të duket sikur vlerësohet i njëjti fëmijë, të njëjtët prindër, vetëm se ndryshojnë emrat, adresat apo mosha e vendndodhja. Në këto raporte interesi më i lartë apo më i mirë i fëmijës duket i përdorur më shumë si një slogan i përsëritur në vlerësimet shabllone se sa i konkretizuar me realitetin specifik para dhe pas zgjidhjes së çështjes. Ka raste kur raporti vlerësues i depozituar nuk ka informuar apo përcjellë realitetin pas fasadës në dukje, para vendim marrjes së gjykimit.

5. Një listë e problemeve reale që paraqiten gjatë procedimit ligjor në gjykatat shqiptare.

- Psikologët thirren (zgjidhen) nga gjyqtarët (seksioni familjar/penal) në rastet të cilat kanë në qendër të miturin dhe interesin e tij madhor;

- Kryetari i gjykatës shpall listën e ekspertëve të licencuar, sipas fushave përkatëse, por kjo listë mungon për psikologët dhe punonjësitsocialë (mjafton të hulumtohet pak në faqet web të gjykatave për të kuptuar se një listë e tillë mungon ndërkohë që për ekspertët e tjerë është e pranishme),

- Mungojnë të dhënat mbi kualifikimet e psikologëve dhe secili prej tyre zgjidhet sipas “preferencave” të gjyqtarit, duke i bërë ata të “prekshëm” ndaj pozicionit të gjyqtarit, gjë që ndikon direkt në cilësinë dhe objektivitetin në gjykim,

- Ata janë në rolin e ekspertit të jashtëm, të cilët paguhen nga pala paditëse (në raste të veçanta, kur e çmon gjykata, nga të dyja palët ose nga pala e shpallur fajtores në rastin e çështjeve penale)

- Tarifat e psikologëve janë shumë të larta (nga 15 000 – 40 000 lekë të reja) dhe të ndryshme në gjykata të ndryshme,

- Nuk ekziston një tarifë fikse e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për shërbimin e psikologut,

- Pagesa e tarifës bëhet me lekë në dorë psikologut dhe paradhënie duke ulur objektivitetin dhe paanshmërinë dhe cilësinë e vlerësimit të tij,

- Nuk merret parasysh gjendja ekonomike dhe pamundësia paguese e palëve duke u bërë element frenues në realizimin e të drejtës në gjykatë (gjë që çon deri në pushim të çështjes),

- Psikologu takon palët vetëm për disa minuta (koha e një konsumimi kafeje) dhe ndalet të pyesë fëmijët në korridoret e gjykatës ose në mjedise të papërshtatshme për të realizuar qëllimin e tij “*marrjen në pyetje e vlerësimin e situatës reale*”.

- Shumica e mendimeve të shprehura në raportet e dhëna prej tyre janë kopje të raporteve paraardhëse me të vetmin ndryshim atë të gjeneraliteteve të palëve, pa u thelluar në specifikat e rastit konkret dhe pa dhënë udhëzime dhe këshilla të vlefshme të cilat e bëjnë gjykatën të reflektojë në gjykimin e saj, në zgjidhjen reale të problemeve duke bashkëpunuar me institucionet ekzekutuese të vendimit gjyqësor apo institucionet e tjera përgjegjëse si: Shërbimi Social Shtetëror, Prokuroria, Zyra e shërbimit social pranë qeverisjes lokale apo shërbimet e përkujdesit shoqëror etj.

- Nuk ofrohen kualifikimeve specifike për këtë pozicion nga sistemi i drejtësisë, ashtu sikundër ofrohen kualifikime për pozicionin gjyqtarë dhe prokurorë,

- Pjesa më e madhe e psikologëve janë të palicensuar pranë organeve tatimore dhe të pakualifikuar për t'iu përgjigjur rastit konkret që ndiqet prej tyre.

- Mungon bashkëpunimi i psikologëve gjyqësor me ata që veprojnë në Shërbimin Social Shtetëror apo ata që janë pjesë e zyrave të shërbimit social pranë qeverisjes vendore në ofrimin e të dhënave për rastet e riskut, ndjekjes së rastit që nga marrja dijeni për problemin social të mbartur nga familja dhe i mituri, monitorimi nga organet përkatëse të zhvillimit të rastit si dhe bashkëpunimi midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve konkrete për problemet sociale të evidentuara,

- Në shumë raste, gjatë shqyrtimit të çështjeve civile të dhunës në familje ndaj të miturve, prania e psikologut mungon, kjo për faktin e thjeshtë se, ata nuk kanë mundësi fizike të marrin pjesë gjatë procedimit të shpejtë i cili realizohet brenda 24 orëve, shërbimi psikologjik ofrohet falas për palën e dhunuar (gjë që i lë psikologët të pambuluar financiarisht),

- Prokuroria, Gjykata dhe Policia kanë në listat e tyre psikologë të ndryshëm për vlerësimin e rasteve të tyre, angazhojnë psikologë të ndryshëm madje dhe në rastet që kanë në qendër të njëjtat palë duke shtuar kostot financiare për palët, por dhe duke i mohuar organit tjetër të ketë mundësi të elaborojë më tej mendimin profesional të krijuar nga eksperti në një fazë të caktuar të hetimit gjyqësor. Psikologu duke qenë në kontakt me të miturin në mënyrë konstante dhe të vazhdueshme ka mundësi të kuptojë më mirë atë dhe situatën në të cilën ai gjendet duke i dhënë një zgjidhje më korrekte dhe vetë rastit.

Në rastin e përzgjedhjes së psikologëve nga organi i Policisë, këto mund të thirren nga listat e afishuara nga Gjykata dhe Prokuroria, por mund të jenë të aksesueshme dhe nga organe të tjera publike dhe private p.sh. OJF të cilat ofrojnë shërbime psikologjike apo ekspertë nga shërbimi social pranë Bashkisë apo Komunës ose Shërbimi Social Shtetëror apo psikologët që veprojnë në sistemin arsimor etj.

6. Përmbledhje e konkluzioneve dhe sugjerimeve

Instrumenti i Psikologut si garantues i së drejtës së individit për t'u dëgjuar në një proces të rregullt, të drejtë dhe të barabartë gjyqësor lipset të respektojë standardet

bazë mbi të cilat mbështetet ai, ato të drejtësisë, të paanshmërisë, korrektësisë dhe profesionalizmit.

Kostoja e lartë ekonomike e një procesi gjyqësor (pagesa e çmimit të kërkesë padisë, tarifa e avokatit, shpenzimet për pagesën e ekspertit, tarifa e njoftimeve ligjore gjatë procesit) është në ngarkim dhe paguhet paraprakisht dhe në më të shumtën e rasteve nga pala e dëmtuar, e rrezikuar apo më e varfër, duke e detyruar atë shumë herë të heqë dorë nga realizimi i të drejtës së saj. Në të tilla kushte duke parë numrin e madh të çështjeve të divorcit, të dhunës në familje apo të veprave penale që kanë në qendër të tyre të miturin dhe ku prania e ekspertit psikolog është thelbësore, na çojnë drejt kërkimit të një zgjidhjeje alternative për zbutjen e kostos sociale në realizimin e të drejtës së individit.

Integrimi i psikologut në strukturat e gjykatës i vjen në ndihmë këtij target grupi i cili është i pamundur për të përmbushur detyrimet financiare të procesit gjyqësor, garanton një shërbim cilësor të rastit, bën koordinimin me aktorët e tjerë të shërbimeve sociale në vend për të vazhduar më tej monitorimin e problemit, zgjidhjen e tij dhe realizon integrimin shoqëror të të miturit me sa më pak trauma në të ardhmen.

Në disa gjykata, psikologu është tentuar të thërritet nga radhët e stafëve të OJF-ve të cilat ofrojnë disa shërbime sociale por në më të shumtën e rasteve kjo ka mbetur në nivelin e bashkëpunimeve sporadike, të mirëkuptimit dhe dëshirës së mirë të gjyqtarit për të garantuar mbarëvajtjen e procesit pasi palët nuk mund të paguanin tarifat e psikologëve.

Institucionalizimi i psikologëve dhe punonjësve socialë pranë gjykatës, jo vetëm si ekspertë të jashtë të saj, por edhe në një strukturë të brendshme, do t'i japë një frymëmarrje të re procesit, do të garantojë të drejtat e palëve dhe do të ofrojë përjasje e zgjidhje të reja të problemit ashtu sikundër shmang indiferencën e organeve kompetente si dhe të komunitetit ndaj fenomeneve dhe pasojave sociale.

Psikologët dhe punonjësit socialë të përfshirë në sektorin e drejtësisë kanë nevojë të trajnohen e kualifikohen më tej për të pasuruar eksperiencën, metodën e vlerësimit, përsosur gamën e pyetjeve që bëjnë në përputhje me karakteristikat dhe tipologjinë e individëve të përfshirë si dhe me specifiken e çështjeve. Në këtë situatë bashkëpunimi i Urdhrave përkatës me organet e drejtësisë është i nevojshëm.

Kompetencat profesionale të psikologëve janë të pa mjaftueshme. Kualifikimet, trajnimet, eksperiencat e ngjashme, dhe vëzhgimi i ambienteve të fëmijëve, i psikopatologjive familjare, matja e impaktit të divorcit të fëmijët, të gjitha këto duhet të ndihmojnë në mënyrë më të ndjeshme për përgatitjen e vlerësimeve.

Raportet vlerësuese të psikologëve kanë nevojë të përmirësohen. Ato duhet të përmbajnë dhe interpretimet e bazuara në ligj pikërisht, ato që rregullojnë kombinimin e kapaciteteve të prindërimit me atë të mbrojtjes dhe nevojave për përkujdesje të fëmijëve; të përmbajnë propozime për ndërhyrje bazuar në skemat ekzistuese sociale që iu ofrojnë prindërve njohuritë e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe kujdes të mjaftueshëm për fëmijën

Ka ardhur momenti për kategorizimin apo specializimin me qëllim rritjen e cilësisë, për grupe çështjesh të psikologëve të punësuar në organet e drejtësisë p.sh ata që do të punojnë me çështjet e divorcit, kujdestarisë, përgjegjësisë prindërore; me vlerësimet për shpërblime dëmi; vlerësimin e dëmit të shëndetit apo psikologjik shkaktuar për çështje të ndryshme etj. Trajnimet klinike të psikologëve që angazhohen me çështjet gjyqësore duhet të synojnë më mirë në perfeksionimin e teknikave investigative të tyre në të gjithë faktorët që përcaktojnë kushtet, statusin dhe kapacitetet, dinamikën e familjes dhe komunikimin; mjedisin kulturor, sjelljet e palëve dhe mbi të gjitha nevojat e mirëqenies fizike, edukative dhe psikologjike të fëmijëve.

Sugjerime:

Ekspertët e jashtëm psikologë e punonjës socialë duhet të jenë gjithashtu të institucionalizuar, sikurse ekspertët e tjerë, me qëllim që të jenë struktura të gatshme e të përgatitura kur kërkohet shërbimi i tyre jo vetëm nga gjykata, por edhe nga palët. Por, për të përmirësuar cilësinë e kualifikimit profesional, si dhe për të lejuar aksesin e qytetarëve që nuk kanë mundësi për kosto të larta, sugjerojmë krijimin e strukturave si më poshtë:

Integrimi i psikologut/punonjësit social në strukturën e brendshme të gjykatës

Pas pasqyrimin të situatës që ndeshet sot në gjykatat tona në raport me angazhimin e psikologëve gjatë procedimit gjyqësor, do të ishte e udhës të krijohet mundësia e integrimit ose atashimit të një strukture të limituar psikologësh pranë

gjykatave të shkallës së parë. Ky grup i përbërë nga disa (sipas nevojave) psikologë në rolin e ekspertëve do të ishin pjesë përbërëse e administratës gjyqësore, me një varësi ligjore dhe hierarkike të tipit 2-fishe, për shembull, me emërim nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili bën dhe monitorim të punës së psikologut, dhe ushtrim të funksionit pranë gjykatave kompetente. Si tregues rezultativ i punës së psikologut do të shërbejë numri i çështjeve të apeluara për shkaqe të lidhura me cilësinë e shërbimit të ofruar nga psikologu, duke ndikuar direkt në vazhdimësinë e kryerjes së mëtejshme të detyrës së tij. Angazhimi i këtij ekipi në strukturën e gjykatës krijon mundësi për një ndjekje të rastit që nga fillimi i hetimit gjyqësor e deri në dhënien e mendimit profesional të argumentuar mbi bindjen e tyre, të formuar gjatë takimeve më të shpeshta me palët dhe të miturin në ambiente komode, duke shfrytëzuar dhe informacionet e shkëmbyera midis Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Pushtetit lokal apo Shërbimit Social Shtetëror për të kuptuar më mirë rastin dhe problematikën. Psikologët, si pjesë e administratës gjyqësore, do të kenë mundësi të ofrojnë shërbimet e tyre gjatë hetimit penal dhe do të asistojnë organin e akuzës (polici, oficerë të Policisë Gjyqësore, Prokurori) në rastet me në qendër të miturin duke ndihmuar në krijimin e një mendimi sa më të plotë dhe korrekt të rastit duke rritur kështu dhe efikasitetin dhe efikasitetin e këtij shërbimi që i përgjigjet hetimit penal në çdo kohë dhe rrethanë. Ekspertët e brendshëm do të caktohen me short nga Kryetari i Gjykatës për vlerësimin e rastit të të miturit. Ata do të fitojnë titullin e ekspertit psikolog gjyqësor në bazë të kualifikimeve përkatëse ose/dhe pasi t'i jenë nënshtruar provimit të Shtetit dhe marrjes së licencës si profesionistë të lirë "PSIKOLOG". Të tillë profesionistë mund të ofrojnë shërbimet e tyre pranë Institucioneve të vuajtjes së dënimit të të miturve, Institucionit të shërbimit të provës, shërbimet sociale lokale dhe kombëtare, duke monitoruar e raportuar rastet e ndjekura që nga faza e hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor, gjatë vuajtjes së dënimit dhe rehabilitimit shoqëror duke krijuar një kuadër sa më të plotë mbi ecurinë dhe përmirësimin e të miturit dhe përshtatjen e tij me ndryshimet sociale dhe të karakterit.

Integrimi i psikologut në strukturën e brendshme të gjykatës, mbart me vete një sërë problematikash dhe avantazhesh të renditura si më poshtë në konkretizim të këtij propozimi.

Ndër elementet pozitive mund të renditen:

- Më pak kosto ekonomike në ngarkim të familjeve shqiptare me probleme të rënda ligjore duke i ardhur në ndihmë konkretisht të miturit,

- Ofrimi i një shërbimi cilësor e profesional në trajtimin e rasteve problematike dhe ndihmës konkrete për to, nëpërmjet krijimit të aksesit për personat e kualifikuar në këtë pozicion në bazë të meritës,

- Garantimi të një pozicioni komod të psikologut si ekspert në trajtimin, ndjekjen dhe monitorimin e rastit,

- Mbrojtja e psikologut kundrejt “Preferencave dhe Ndikimeve të gjyqtarit”,

- Sigurimi i një bashkëpunimi midis policisë – prokurorisë - gjykatës në ndihmë të të miturit,

- Ulja e rasteve të korrupsionit në gjykatë midis gjyqtarit dhe psikologut duke shmangur sigurimin e rastit të radhës nëpërmjet dhënies së ryshfetit,

- Arritja e koordinimit, bashkëpunimit, relatimit dhe monitorimit të rasteve problematike në institucionet përkatëse (shëndetësi, arsim, Shërbim Social Shtetëror, zyrat e shërbimit social lokal, qendrat pritëse shtetërore e private)

Ndër pikat më të dobëta renditen:

- Ngarkimi me një kosto financiare të financave të pushtetit gjyqësor apo të Ministrisë së Mirëqenies Publike (sipas rastit dhe përgjegjësive konkrete të secilës Ministri) në:

A. Paga (e cila mund të dalë nga tarifa të vogla dhe pranueshme që mund të paguajnë palët.

B. Ambiente të posaçme.

C. Kualifikime përkatëse të psikologëve gjyqësor etj shpenzime si këto.

- Kërkon një përmirësim dhe adaptim të kuadrit ligjor mbi rolin dhe funksionimin e psikologut në sistemin e drejtësisë.

- Prek dhe cenon interesa klienteliste dhe përfitimi të vendosura midis aktorëve në procesin gjyqësor dhe në të gjitha hallkat e procedimit ligjor.

Aktivizimi në gjykatë i psikologëve/punonjësve socialë që shërbejnë pranë zyrave vendore të shërbimeve sociale.

Një mundësi tjetër shumë e rëndësishme do të ishte përgatitja e strukturave të psikologëve dhe punonjësve socialë që punojnë në zyrat e bashkive apo organeve vendore. Kjo do të forconte gjithashtu shërbimin e psikologut dhe punonjësit social në gjykatë dhe do të minimizonte kostot e tij.

Kjo nevojitet në rregullimin e detyrave të psikologut/punonjësit social në raport me mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Njohja nga legjislacioni e mundësisë së ekspertizës së psikologut/punonjësit social për palët, me qëllim lejimin e kontradiktoritetit në procesin gjyqësor. Krijimi i dy regjistrave të ekspertëve pranë gjykatës: ekspertëve psikologë e punonjës socialë të gjykatës dhe veç regjistri i ekspertëve të palëve.

- Nevoja urgjente për institucionalizimin e ekspertëve psikologë/punonjës socialë, nëpërmjet listave, përcaktimit të kriterëve të pranimit dhe procedurave të pranimit;
- Krijimi i rrjetit të psikologëve punonjësve pranë gjykatës me pagesa të tarifave normale të arsyeshme dhe jo pagesa të papërbalueshme.
- Krijimi i rrjetit me një listë të veçantë të psikologëve/të palëve.
- Ngritja e njësive të psikologëve dhe punonjësve socialë të specializuar pranë organeve vendore, për t'iu përgjigjur nevojave të Gjykatës për ekspertizë në rastin e shtresave në nevojë.
- Miratimi i programeve të kualifikimit dhe të trajnimit, si dhe i testimit nga urdhrat përkatës;
- Kualifikimi vazhdues për njohjen e parimeve dhe kërkesave për një proces të rregullt ligjor, si dhe për etikën në marrëdhëniet me palët e gjykatën.
- Miratimi i kriterëve dhe procedurave të pranimit nga urdhrat përkatës.
- Ndryshime të KPr.Civile dhe Penale, për përcaktimin më të qartë të detyrave të ekspertëve psikologë e punonjës socialë dhe të mënyrës së regjistrimit të tyre.
- Këto ndryshime nuk mund të bëhen në kuadrin e rregullimit të të gjithë ekspertëve, por të jetë e adresuar qartë.
- Propozimi për amendamente ligjore nga urdhrat përkatës nëse kanë nevojë për bazë ligjore që të realizojnë sa më sipër..

Literatura:

Baza ligjore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
- Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”
- Konventa e OKB “Për të drejtat e fëmijëve”
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Konventa Europiane “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”
- Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”

Publikime

- Arta Mandro-Balili, *E drejta Familjare*, Emal, Tiranë 2009.
- Arta Mandro-Balili, *Parimi i Interesit më të lartë të fëmijës dhe sfidat e zbatimit të tij*, Revista ‘Jeta Juridike’ 2008
- Klodian Gega, Nuredin Hasani, *Psikologu dhe punonjësi social në drejtësinë për të miturit*, Udhërrëfyes gjithëpërfshirës, Botim i Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integuara Klinika Ligjore për të Mitur-Tiranë.
- *Studim për viktimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale*, Linja e Këshillimit për gra dhe vajza, Tiranë Shtator 2013
- Cesare Maria Calabrese, Lorenza Ferrar, *Lo psicologo Giudice Onorario al Tribunale per i Minorenni*, Gruppo Psicologia Forense Liguria Italia
- M. Malagoli Togliatti, *Linee Guida per l’ascolto del minore nelle separazioni e divorzi*, Ordine degli psicologi del Lazio, 2011/2012
- Dare Alessandra, *Lo psicologo nel sistema di trattamento della delinquenza minorile. Italia e Francia a confronto*, Padova 2003
- *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri*. Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri – Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri – CRCA, Tiranë Qershor 2007
- Manuali i psikologut në gjykatë.pdf.

Web page

www.instat.gov.al

www.gjk.gov.al

www.gjykataelarte.gov.al

www.gjykatatirana.gov.al

www.unicef.org/albania/Manuali_i_psikologut_ne_gjyKate.pdf